

Vendim nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë”

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Pika 2, Gërma a	Oficeri i sigurisë përmirëson sigurinë faktike dhe të perceptuar në ambientet e shkollës dhe ambientet përreth.		
Pika 2, Gërma b	Oficeri i sigurisë garanton një mjedis të sigurt për nxënësit brenda në shkollë si dhe në territorin përreth saj.		
Pika 2, Gërma c	Oficeri i sigurisë parandalon dukuritë negative që në gjenezë, duke evidentuar dhe ndërmarrë hapa korrektues, në bashkëpunim me personelin mësimor, psikologun/en e shkollës dhe prindërit.		
Pika 2, Gërma ç	Oficeri i sigurisë bashkëpunon me oficerët e policimit në komunitet.		
Pika 2, Gërma d	Oficeri i sigurisë përmirëson perceptimin e figurës së tij te nxënësit dhe të marrëdhënieve ndërmjet tyre e policisë.		
Pika 4, Gërma a	Kandidati për oficer sigurie është shtetas shqiptar.		
Pika 4, Gërma b	Kandidati për oficer sigurie ka zotësi të plotë për të vepruar.		
Pika 4, Gërma c	Kandidati për oficer sigurie është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.		
Pika 4, Gërma ç	Kandidati për oficer sigurie nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.		
Pika 4, Gërma d	Kandidati për oficer sigurie nuk ka marrë masë disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë.		
Pika 4, Gërma dh	Kandidati për oficer sigurie ka diplomë të ciklit të dytë ose diplomë të barasvlershme me të në fushën e edukimit, të shkencave sociale, sociologjisë, psikologjisë, drejtësisë.		
Pika 4, Gërma e	Kandidati për oficer sigurie është jo më shumë se 40 vjeç		
Pika 4, Gërma f	Kandidati për oficer sigurie ka njohuri të mira kompjuterike.		
Pika 5	Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit, konkurrimit dhe shpallja e rezultateve të konkurrimit për oficerin e sigurisë, janë bërë sipas procedurave të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.		
Pika 6	Marrëdhëniet e punës të oficerit të sigurisë kanë filluar pas përfundimit me sukses të trajnimit pranë Akademisë së Sigurisë dhe janë rregulluar në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.		